



Npi – 01/176 datë: 02.05.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 7, 8, 10 të Ligjit për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr.04/L-071; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi listën e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve Npi – 01/45 datë: 12.02.2025, dhe duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komisionit Npi-01/60 të datës 13.03.2025, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/118 të datës 01.04.2025, Kuvendi i Komunës në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 02.05.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS TË ALBAN RASHITI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e jashtëzakonshme, të mbajtur më: 02.05.2025, me shumicën e votave vendosi të REFUZOJË Kërkesën Nr: 06-350/02-30686/24 datë:26.11.2024, të Alban Rashiti për ndërrimin e emrit të sheshit “Shaban Jashari” në Petrovë me emrat alternativ të propozuar “Sheshi i Dëshmorëve” ose “Dëshmorët e Petrovës”.

II

K ë r k e s a: z.Alban Rashiti, Rr. “Fadil Rashiti” Nr.47 Petrovë, Kërkesa Nr: 06-350/02-30686/24 datë:26.11.2024, ka kërkuar ndërrimin e emrit të sheshit “Shaban Jashari” në Petrovë me emrat alternativ të propozuar “Sheshi i Dëshmorëve” ose “Dëshmorët e Petrovës”, ose edhe të merret ndonjë ide tjetër. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë petition ose nënshkrime të banorëve të zonës. Pala nuk ka ofruar ndonjë arsyetim për ndërrimin e këtij emri.

III

- A r s y e t i m: Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes në mbledhjen e mbajtur më 06.12.2024, unanimisht miratoi Konkluzionin Npi-01/403 datë 06.12.2024 me të cilin vendosi që ta diskutojë edhe një herë më detaisht këtë kërkesë, me një përbërje më të kompletuar të Komisionit.
- Komisioni për shqyrtimin e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve në Komunën e Shtimes me rekomandimin Npi-01/60, pas grumbullimit të informatave, në mbledhjen e mbajtur më 18.12.2024, unanimisht vendosi që ti Rekomandon Kuvendit, Refuzimin e Kërkesës Nr:06-350/02-30686/24 datë: 26.11.2024, të Alban Rashiti – Petrovë, për ndërrimin e emrit të sheshit “Shaban Jashari” në Petrovë me emrat alternativ të propozuar “Sheshi i Dëshmorëve” ose “Dëshmorët e Petrovës”, mbetet emri i vjetër “Shaban Jashari”, për arsye të rendësisë së madhe që ka.
- Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 01.04.2025 miratoi Rekomandimin, Npi – 01/118, me të cilin Kuvendit të Komunës i Rekomandon Refuzimin e kësaj kërkesë.
- Duke marrë parasysh të gjitha këto Kuvendi mori vendim sikurse në Dispozitiv.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi